

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6581  
E martë, 12 prill 2022  
çmimi 0.40

Zelensky kërkon  
më shumë ndihmë  
nga jashtë | FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## ZHVILLIMET E FUNDIT ME DICK MARTYN, TREGUES SE NË HAGË NUK KA SUBSTANCË TË BESUESHME PËR TRAJTIM



Raportimet se Dick Marty është cak për ekzekutim nga shërbimet sekrete serbe, është përpjekje për njoftimin e luftës së UÇK-së dhe dëmtimin e imazhit të Kosovës, ka thënë të hënën, në një konferencë për medie, nënkryetarja e Partisë

Demokratike të Kosovës, Vlora Çitaku. Ndërkaq përfaqësues të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) kanë theksuar se është turp nga Këshilli i Evropës që nuk merret tani me trafikimin e

organeve që nuk ekziston në Gjykatën Speciale e të tregojë se ky ishte trillim. Ndërsa ish-këshilltari i Hashim Thaçit, Artan Behrami, ka thënë se Prokuroria e Gjykatës Speciale duhet ta thërrasë Dick Marty në dëshmitar

### AKTUALE



**KURTI: SHOIPTARËVE NË LUGINË U ËSHTË BËRË PADREJTËSI E MADHE ME PASIVIZIMIN E MBI 6 000 ADRESAVE** F. 3

**OSMANI U PËRGJIGJET QYTARËVE: ME KURTIN KAM RAPORTE TË SHKËLQYESHME** F. 3

**SHOIPRIM ARIFI, KRYETAR I RI I PRESHEVËS** F. 3

**DËSHMITARI I TETË I MBROJTJES: ARRESTIMI I SALIH MUSTAFËS, I PADREJTË** F. 6



### EKONOMI



**QEVERIA KA AFAT EDHE DHJETË DITË PËR SHOYRTIMIN E PROPOZIMIT PËR TËRHEQJEN E KONTRIBUTEVE NGA TRUSTI** F. 7

**BB: EKONOMIA E UKRAINËS GATI SE DO TË PËRGJYSMOHET** F. 7

## PAS ARMATOSJES SË SERBISË NGA KINA, MEHAJ: TË REAGOJNË NATO-ja E BE-ja, PO MINOHET PAQJA NË BALLKAN

| FAQE 6

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Zelensky kërkon më shumë ndihmë nga jashtë

KIEV, 11 PRILL - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, tha se vendi i tij ka nevojë për më shumë ndihmë nga jashtë për t'i mbijetuar pushtimit të paprovokuar nga Rusia. Duke folur përmes videolidhjes me ligjvënësit e Koresë së Jugut, Zelensky tha se Rusia nuk do ta ndalojë luftën që ka nisur në fund të shkurtit, nëse nuk detyrohet nga komuniteti ndërkombëtar.

Ai shtoi se Rusia po dërgon dhjetëra mijëra trupa për ofensivën e saj të radhës në pjesën lindore të Ukrainës. "Mariupoli është shkatërruar, ka dhjetëra mijëra të vdekur por, përkundër kësaj, rusët nuk e ndalin ofensivën", tha Zelensky.

Shifrat që ai përmendi nuk janë verifikuar në mënyrë të pavarur. Mariupoli, qytet port në juglindje të Ukrainës, është rrethuar nga forcat ruse tash e sa javë.

## Bie numri i refugjatëve ukrainas në Poloni

Garda Kufitare polake ka thënë se mbi 2.6 milionë njerëz kanë ikur nga Ukraina në Poloni prej sulmit të paprovokuar të Rusisë

në Ukrainë. Sipas Gardës, numri i njerëzve që kalojnë kufirin drejt Polonisë ka rënë ndjeshëm në javët e fundit dhe se është rritur numri i atyre që po kthehen në Ukrainë.

Të dielën, 28 5000 njerëz kanë hyrë në Poloni, apo 2 për qind më pak sesa të shtunën, ka njoftuar kjo agjenci në "Twitter". Profesori për kërkime rreth migrimit në Universitetin e Varshavës, Maciej Duszczzyk, ka vlerësuar që 1.2-1.4 milion ukrainas vazhdojnë të jenë në Poloni.

Më shumë se 800 000 prej tyre tani janë regjistruar dhe kanë dokumente polake të identifikimit.

## Borrelli thotë se sërish do të ketë sanksione kundër Rusisë

Shefi i politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Josep Borrell, tha se sanksionet e mëtejshme kundër Rusisë, për shkak të pushtimit të paprovokuar të Ukrainës, mbeten opsion.

Borrell i bëri këto komente në Luksemburg në prag të një takimi të ministrave të Jashtëm të BE-së. "Sanksionet janë



gjithmonë në tryezë", u tha ai gazetarëve.

Borrelli shtoi se ministrat, të cilët pritet të diskutojnë për krimet e dyshuara të luftës, të kryera nga Rusia në Ukrainë, bashkë me prokurorin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare, Karim Kahn, mund të debatojnë edhe për "hapat e mëtejshëm" kundër Moskës.

BE-ja ka vendosur tashmë disa

raunde sanksionesh kundër Rusisë.

Disa vende brenda bllokut 27-anëtarësh kanë bërë thirrje për embargo të plotë mbi naftën ruse, por disa të tjera kanë hezituuar, për shkak të, siç kanë thënë, ndikimit që do të kishte një masë e tillë në ekonominë e tyre.

Në muajin mars Shtetet e Bashkuara kanë marrë vendim për ndalimin e importit të

naftës ruse.

Varësia e ShBA-së nga Rusia, megjithatë, është më e vogël.

Për krahasim, BE-ja merr rreth 40 % të gazit dhe 30 % të naftës së saj nga Rusia dhe nuk ka zëvendësues të lehtë të tyre, nëse furnizimet ndërpriten.

ShBA-ja, ndërkaq, ka siguruar rreth 8 për qind të importeve të naftës nga Rusia.

ShBA-ja nuk importon gaz natyror nga ky vend.

# Sondazhet: Macron dhe Le Pen përballen në raundin e dytë

PARIS, 11 PRILL - Presidenti aktual i Francës, Emmanuel Macron, dhe kandidatja e ekstremit të djathtë, Marine Le Pen, do të përballen në raundin e dytë të zgjedhjeve më 24 prill, sipas sondazheve të para.

Të dielën francezët votuan në raundin e parë të zgjedhjeve presidenciale, ku garuan 12 kandidatë. Sipas sondazheve të para pas mbylljes së vendotimeve, Macron ka marrë 28.1 për qind të votave, ndërkaq Le Pen 23.3.

Në zgjedhje të drejtë vote kanë pasur 48.7 milionë votues.

Presidenti i ri do të ketë fuqinë që ta formësojë Francën dhe rolin e saj kyç në Evropë në pesë vjetët e ardhshëm. Edhe pse zgjedhjet janë lënë në hije nga lufta e Rusisë në Ukrainë, për shumicën e votuesve çështja kryesore në këto zgjedhje është



kostoja e jetesës.

Macron dhe Le Pen kanë pikëpamje shumë të ndryshme sa i përket politikës së jashtme dhe qasjes ndaj Rusisë, por edhe Bashkimit Evropian. Po

ashtu, ata kanë edhe pikëpamje të ndryshme lidhur me financat publike apo për investitorët e huaj.

Një fitore e Macronit do të thoshte një vazhdimësi për

Francën, ndërkaq një fitore e Le Pen do të nënkuptonte ndryshime të mëdha.

Tani që Britania është larguar nga BE-ja, Franca është fuqia kryesore ushtarake e bllokut. Po

ashtu, është ekonomia e dytë më e madhe, dhe largimi nga politika e ish-kancelares gjermane, Angela Merkel, i ka dhënë Macronit një rol më të rëndësishëm në Evropë. Një fitore e Le Pen do ta përplaste Francën me partnerët e BE-së.

Shqetësimet kryesore për votuesit, sipas sondazheve parazgjedhore, ishin rritja e madhe e çmimeve të energjisë dhe rritja e inflacionit.

Sondazhet, po ashtu, treguan se votuesit ishin të pakënaqur me politikat ekonomike të Macronit, edhe pse niveli i papunësisë është më i ulët ndër vite. Po ashtu, mënyra sesi

Macron ka menaxhuar pandeminë e koronavirusit, u tha se mund të luajë rol në këto zgjedhje, pavarësisht se kufizimet kundër Covid-19 pothuajse janë hequr të gjitha.

# Kurti: Shqiptarëve në Luginë u është bërë padrejtësi e madhe me pasivizimin e mbi 6 000 adresave

**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 11 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, bashkë me ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka pritur të hënën në takim përfaqësuesit politikë të shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc. Gjatë këtij takimi u diskutua për rezultatet e procesit zgjedhor në Serbi, veçanërisht në tri komunat me shumicë shqiptare. Në këto zgjedhje morën pjesë edhe partitë shqiptare të cilat garuan me dy lista, "Koalicioni i Shqiptarëve të Bashkuar" dhe "Alternativa Demokratike Shqiptare". "Shqiptarëve në Preshevë,

Medvegjë dhe Bujanoc u është bërë padrejtësi e madhe me pasivizimin e mbi 6 000 adresave të banorëve shqiptarë në këto komuna", ka thënë Kurti, duke shtuar se ky është një spastrim etnik administrativ i heshtur e që po sjell pasoja të mëdha. "Kjo metodë e Serbisë, që ua mohoi të drejtën elementare e demokratike, atë të votës, solli edhe rezultate jo të kënaqshme. Andaj, këto zgjedhje as nuk ishin të lira, as demokratike, tha ai. Mungesa e unitetit dhe e bashkërendimit të subjekteve politike shqiptare në një front ishte një faktor tjetër i dëmshëm për rezultatet zgjedhore", ka veçuar kryeministri. Ai më tutje ka shtuar se gjendja e shqiptarëve në



përgjithësi në këto komuna, me politika diskriminuese dhe shtypëse të Serbisë, kërkon

angazhim të përbashkët e vigjilencë të shtuar, vendosmëri dhe ruajtje të

unitetit politik të subjekteve shqiptare të Preshevës, Medvegjës e Bujanocit.

## Shqiprim Arifi, kryetar i ri i Preshevës



PRISHTINË, 11 PRILL - Kuvendi i Preshevës ka votuar të hënën për shkarkimin e Ardita Sinanit nga pozita e kryetares së Preshevës. Pas përfundimit të seancës së jashtëzakonshme, në të cilën është shkarkuar kryetarja Ardita Sinani, është thirrur seanca e katërt për emërimin e kryetarit të ri. Në këtë seancë të Kuvendit Komunal në Preshevë, me 20 vota për, Shqiprim Arifi është zgjedhur kryetar i komunës. Në pozitën e zëvendëskryetarit të

komunës së Preshevës është emëruar Almin Shaqiri. Në seancën e së hënës të kuvendit me shumicë votash është votuar edhe lista e anëtarëve të Këshillit Komunal. Në këtë mbledhje të rregullt këshilltarët e shumicës kanë shkarkuar zëvendëssekretarin e kuvendit dhe kanë emëruar në këtë pozitë Mendim Berishën. Sinani është shkarkuar nga pozita e kryetares së Preshevës pasi partnerët e koalicionit nga radhët e Lëvizjes për

Reforma nuk patën vullnet ta vazhdojnë koalicionin, pa dhënë arsye për largimin e tyre nga kryetarja Sinani dhe bashkimin me partinë e kryetarit nga Alternativa për Ndryshim. Ardita Sinani është zgjedhur në krye të Preshevës më 21 maj të vitit 2021 si pjesë e Partisë për Veprim Demokratik (PVD). Për kryetarin e ri të kësaj komune, Arifin, kjo është hera e dytë që vjen në pozitën e kryetarit, pas fitores që ai pati në zgjedhjet e prillit.

## Osmani u përgjigjet qytetarëve: Me Kurtin kam raporte të shkëlqyeshme

PRISHTINË, 11 PRILL - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka bashkëbiseduar me qytetarët përmes rrjetit social "Instagram". Osmani u është përgjigjur dhjetëra pyetjeve të cilat qytetarët ia kanë parashtruar. Ajo është pyetur se a do të jetë më aktive në dialogun Kosovë - Serbi. "Siç e dini, të gjitha qëndrimet në dialog koordinohen ndërmjet institucioneve tona. Prandaj unë tashmë jam aktive në këtë proces", është përgjigjur Osmani. Presidentja është pyetur edhe për raportet që ka me kryeministrin Albin Kurti. "Çfarë janë raportet mes jush dhe kryeministrit? Të mira, shumë të mira, apo të shkëlqyera?", ishte pyetja drejtuar Osmanit. Osmani është përgjigjur "të shkëlqyeshme deri më tani", duke e shoqëruar përgjigjen

me një ikonë të buzëqeshur. Osmani është pyetur edhe për praninë e Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe botërore. Presidentja ka thënë se deri më tani kanë arritur ta rienergizojnë politikën e jashtme dhe të dëgjohet zëri i Kosovës kudo, në çdo takim e forum ndërkombëtar. "Fatkeqësisht sfidat janë të mëdha, por Kosova asnjëherë s'ka pasur imazh më të mirë në botë. Ashtu siç ka thënë presidenti Biden: 'Kosova vazhdimisht gjatë këtij viti ka treguar leadership në arenën ndërkombëtare'", është shprehur Osmani. Osmani është pyetur nga qytetarët edhe për flamurin e cilin e barte kudo me vete ish-presidenti Ibrahim Rugova. "A mendon zonja presidente me ndrru flamurin, me vendos atë që e meritojmë, atë të presidentit historik Ibrahim



Rugova?", është pyetur Osmani. Ajo është shprehur se ndërrimi i himnit të Kosovës dhe kriteret e ndryshimit janë të parapara me Kushtetutë. "Në momentin që e kam marrë

detyrën në Presidencë kam rikthyer vullën e presidentit Rugova dhe flamurin dardan në hapësirat e Presidencës. Sa i përket himnit të Kosovës, kriteret e ndryshimit

parashihen në Kushtetutë", u shpreh Osmani. Presidentja gjatë këtij bashkëbisedimi me qytetarët ka marrë edhe lëvdata për punën.



# Zhvillimet e fundit me Dick Martyn, tregues se në Hagë nuk ka substancë të besueshme për trajtim

Raportimet se Dick Marty është cak për ekzekutim nga shërbimet sekrete serbe është përpjekje për njollosjen e luftës së UÇK-së dhe dëmtimin e imazhit të Kosovës, ka thënë të hënën, në një konferencë për medie, nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës, Vlora Çitaku. Ndërkaq përfaqësues të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) kanë theksuar se është turp nga Këshilli i Evropës që nuk merret tani me trafikimin e organeve që nuk ekziston në Gjykatën Speciale e të tregojë se ky ishte trillim. Në anën tjetër, ish-këshilltari i Hashim Thaçit, Artan Behrami, ka thënë se Prokuroria e Gjykatës Speciale duhet ta thërrasë Dick Martyn si dëshmitar

**EPOKA  
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 11 PRILL - Në Kosovë ka pasur reagime të shumta në lidhje me raportimet e fundit për planifikimin e ekzekutimit të ish-senatorit zviceran Dick Marty nga shërbimet sekrete serbe. Reagimet kanë ardhur nga partitë politike opozitare dhe përfaqësues të Organizatës

së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), por jo edhe nga institucionet e Kosovës.

Në një intervistë për mediet zvicerane më 10 prill, Marty ka thënë se ka 16 muaj që është nën mbrojtje të lartë policore për shkak të kërcënimeve me jetë, të cilat, siç ka thënë, i vijnë nga "qarqe të caktuara të shërbimeve sekrete serbe". Ai i

ka akuzuar autoritetet zvicerane se "nuk kanë ndërmarrë asnjë hap apo veprim diplomatik me Beogradin" në lidhje me situatën në të cilën është gjendur.

Marty ka thënë se më 18 dhjetor 2020 ka pranuar një telefonatë nga policia, e cila e ka njoftuar se është i rrezikuar dhe se do të vendoset nën

mbrojtje të lartë policore.

Ai ka thënë se i është ofruar edhe ndryshimi i identitetit dhe adresës, porse nuk ka pranuar. Në atë intervistë Marty ka thënë se kërcënimet me vdekje "kanë ardhur nga qarqe të caktuara të inteligjencës serbe", të cilat, sipas tij, "u kanë kërkuar vrasësve të paguar nga nëntoka që ta likuidonin", për t'i fajësuar më pas "shqiptarët nga Kosova". Megjithatë, Marty nuk ka ofruar asnjë provë për këto pretendime. "U jam mirënjohës njerëzve që më ofrojnë mbrojtje, por është e qartë se kjo nuk mund të vazhdojë pafundësisht. Nuk ka të bëjë vetëm me mua. Të gjithë ata që janë në kërkim të së vërtetës, meritojnë jo vetëm mbrojtje, por edhe drejtësi", ka thënë Marty në intervistë.

Marty ka qenë autor i një raporti për Këshillin e Evropës në vitin 2010, në të cilin ai ka dënuar krimet e supozuara të UÇK-së, përfshirë "trafikimin e organeve njerëzore". Raporti është vërtetuar praktikisht me një raport të ri nga prokurori amerikan Clint Williamson në vitin 2014. Vitin pasues, më 2015, është formuar pastaj Gjykata Speciale në Hagë për krime lufte në Kosovë, ku tashmë ish-udhëheqësit e UÇK-së po mbahen në paraburgim.

Lajmi për planifikimin e ekzekutimit të ish-senatorit zviceran Dick Marty nga shërbimet sekrete serbe, nga përfaqësues të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) është parë shqetësues, për faktin se është vërtetim i manipulimit që i është bërë

ish-senatorit Marty nga shërbimet sekrete serbe, të cilat e kanë furnizuar atë me informata të fabrikuara dhe dosje të prodhuara në kabinetet politike në Beograd dhe Moskë, mbi bazën e të cilave është ngritur edhe Gjykata Speciale.

Nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës, Vlora Çitaku, në një konferencë për medie mbajtur të hënën, ka thënë se kjo tendencë e rikonfirmon faktin që Serbia po përpiqet edhe më tej ta njollojë të vërtetën për Kosovën dhe UÇK-në.

Çitaku shtoi se edhe më shqetësues në këtë rast është vërtetimi i manipulimit që i është bërë ish-senatorit Marti nga shërbimet sekrete serbe, të cilat e kanë furnizuar me informata të fabrikuara dhe dosje të prodhuara në kabinetet politike në Beograd dhe Moskë, mbi bazën e të cilave është ngritur edhe Gjykata Speciale. “Pra, nëse një orkestrim për eliminim fizik të Martit nga shërbimet sekrete serbe është evident, vetëm me qëllim që të përpiqen ta njollojnë edhe më tej të vërtetën tonë, është krejt e vërtetuar se një orkestrim për njolloshjen e luftës së UÇK-së nga po të njëjtat struktura dhe e njëjta mendësi, përmes senatorit Marti ka qenë agjendë e mirorganizuar dhe e qëllimshme, e cila s’ka pasur të bëjë asgjë as me të vërtetën, as me drejtësinë. Dhe kjo përbën një absurd për të vërtetën dhe drejtësinë, sepse sot taksapaguesit evropianë paguajnë për një gjykatë e cila është ngritur mbi dezinformatat dhe fabrikimet e shërbimeve sekrete serbe, shtet i cili ka kriminelë lufte me emër e mbiemër që janë të pandëshkuar për krimet e tyre, përderisa në anën tjetër të njëjtit i mundësohet të arrijë deri aty sa të fabrikojë e të manipulojë me dëshmi të rreme për krime lufte të UÇK-së”, ka thënë ajo.

Çitaku konsideron se kjo situatë e krijuar është një shkëndijë fillestare për Kosovën dhe Bashkimin Evropian për të shtruar disa pyetje për të cilat ish-senatori Marti do të duhej të jepte sqarime. “Cilat kanë qenë rrethanat që kanë nxitur apo detyruar z. Marty që t’i hetojë pretendimet e fabrikuara nga shërbimi sekret serb dhe ai rus për trafikimin e organeve nga UÇK-ja? Kush dhe cilat shërbime sekrete i kanë dhënë z. Marty dëshmi e prova mbi të cilat ai ka ardhur në konstatimet e tij për krimet e luftës së UÇK-së? A ka qenë i kërcënuar apo shantazhuar atëherë, dhe a ndihet i manipuluar sot, pasi që vetë jeta e tij është në rrezik, nga po të njëjtat struktura që luajnë edhe rolin e kriminelit edhe të viktimës?”, ka theksuar Çitaku. Ajo ka thënë se kjo çështje vë në pikëpyetje tërë klauzolën e

aktakuzave të ngritura ndaj ish-pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe se do të duhej të prodhonte reflektim edhe tek institucionet e Kosovës, të cilat që nga raportimi i këtij zhvillimi jashtëzakonisht të rëndësishëm, ende nuk kanë pasur kurrfarë qëndrimi. “Nuk është fjala për çështje historike, politike e identitare. Fjala është për bazën mbi të cilën janë ngritur akuza konkrete. Dhe kjo bazë e ka një adresë në Beograd e një në Moskë. E ka një procedurë, shantazhin. Si dhe një qëllim, dëmtimin e imazhit të Kosovës. Duke lënë anash komponentin e drejtësisë, në të cilën besojmë, zhvillimet e fundit me senatorin Marty tregojnë se në Hagë nuk ka substancë të besueshme për trajtim. Prandaj, përballë këtyre ngjarjeve që demaskojnë përpjekjet e shtetit serb kundër lirisë dhe pavarësisë sonë, kundër integritit dhe konsolidimit tonë të jashtëm, ne të gjithë e kemi obligim që ta mbrojmë Kosovën dhe imazhin e saj”, ka thënë Çitaku.

Ndërkaq ish-këshilltari i Hashim Thaçit, Artan Behrami, ka theksuar se pamja dhe e vërteta për Dick Martyn në Kosovë është e njëjtë, përkundër deklaratës së tij se Shërbimi Inteligent Serb ka planifikuar ta vrasë. “Dick Marty mbetet aleati më i madh i Rusisë dhe Serbisë. Gjithmonë ka qenë. Gjithmonë do të jetë. Prokuroria e Gjykatës Speciale duhet ta thërrasë Dick Martyn dëshmitar. Po ashtu, mbrojtja e krerëve të UÇK-së duhet ta ketë të drejtën ta thërrasë atë si dëshmitar. Pa dëshminë e Dick Martyt në Gjykatën Speciale nuk ka proces gjyqësor fer dhe të paanshëm”, ka thënë ai. Behrami ka thënë se Dick Marty po përpiqet të fshihet për të mos dëshmuar në

Gjykatën Speciale meqë, sipas tij, ai dhe të gjithë ne e dimë që raporti i tij ka qenë një fabrikim i dezinformatave ruso-serbe. “Dick Marty në paragrafin 133 të raportit të tij thotë: ‘Ne arritëm të kemi qasje në dëshmi të vërtetuara, të dorës së parë, nga ish-luftëtarët dhe ata që ndihmuan UÇK-në të kryenin transporte të shumta brenda dhe ndërmjet objekteve të përmendura në raportin tonë, si dhe transportimin e robërve nga shumica e tyre’. Dick Marty duhet të tregojë ku i ka marrë informacionet që janë pjesë e raportit të tij për luftën e UÇK-së. Ku janë dëshmitë?”, ka deklaruar Behrami.

Nisma Socialdemokrate, që drejtohet nga Fatmir Limaj, ka kërkuar nga Dick Marty që të bëjë tërheqje publike nga shërbimi sekret serb dhe t’i japë ndihmë drejtësisë. “Tërheqja publike e Dick Martyt nga shërbimi që i ka bërë shërbimit sekret serb që ka planifikuar edhe vrasjen e tij, është ndihma më e madhe që ai mund t’i japë drejtësisë”, është thënë në reagimin e kësaj partie.

Kreu i Aleancës Kosova e Re, Behgjet Pacolli, ka komentuar raportimet se Dick Marty është kërcënuar nga shërbimet serbe dhe se qëllimi ka qenë vrasja e tij që faji t’u bartet qytetarëve të Kosovës. “Nëse është e vërtetë se Dick Marty po kërcënohet nga intelijenca serbe, është koha e duhur që ai të tregojë se si e krijoi narrativën e tij të famshme të organeve, për çka z. Hashim Thaçi sot është në paraburgim në Hagë”, ka shkruar Pacolli në “Facebook”. Në lidhje me këtë lajm ka reaguar edhe ushtruesi i detyrës i kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Faton Klinaku. Ai ka thënë se pretendimet për trafikim të organeve të civilëve serbë nga ana e ish-UÇK-së në zonën kufitare ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës fillimisht u ngritën nga ish-kryeprokurorja e Gjykatës së Hagës, Carla del Ponte, në librin e saj “Gjuetia”, të botuar në vitin 2008. “Pas kësaj një numër organizatash ndërkombëtare kërkuar hetime rreth kësaj çështjeje,

ndërkohë që autoritetet në Prishtinë, por edhe ato në Tiranë, kundërshtuan fuqishëm pohimet, duke kërkuar hetime të paanshme. Zyrtarët në Prishtinë thanë se misioni i OKB-së në Kosovë (UNMIK) dhe Tribunali i Hagës kishin hetuar këto dyshime më parë, por nuk kishin gjetur prova që vërtetonin kryerjen e krimeve të pretenduara. Raporti i Dick Martyt u miratua nga Këshilli i Evropës dhe pati jehonë të madhe në mediet botërore”, ka thënë ai.

Klinaku ka thënë se Serbia ka lobuar dhe ka paguar njerëz në Kosovë dhe jashtë saj (në Evropë), çfarëdo nacionaliteti qofshin ata, për të kryer punë të pista dhe vepra kriminale e për t’i fajësuar shqiptarët. “Se a e vrasin Dick Martyn apo jo, kjo çështje është e shtetit zviceran që t’i bëjë mbrojtje, por është turp nga Këshilli i Evropës që nuk merret tani me trafikimin e organeve që nuk ekziston në Gjykatën Speciale e të tregojë se ky ishte trillim si në filmat fantastiko-shkencorë dhe t’i kërkojë falje Kosovës”, ka thënë Klinaku.

## BIA e Serbisë mohon se ka lidhje me kërcënimet ndaj Dick Martyt

Agjencia Serbe e Zbulimit - BIA - i hodhi poshtë pretendimet e ish-raportuesit të Këshillit të Evropës, Dick Marty, se strukturat serbe të sigurisë kanë planifikuar vrasjen e tij. Marty, ish-senator zviceran, ka hetuar krimet e supozuara të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë në periudhën janar 1998 - dhjetor 2000.

Në një deklaratë për Shërbimin e Ballkanit të “Radios Evropa e Lirë”, BIA tha se i ka dërguar letër Shërbimit Federal të Inteligjencës Zvicerane përmes së cilës i ka mohuar pretendimet për përfshirjen e shërbimeve serbe të sigurisë në “planifikimin e vrasjes së dikujt”. “BIA dënon dhe mohon fuqishëm pohimet dashakeqe për përfshirjen e

shërbimeve serbe të sigurisë në planifikimin e vrasjes së dikujt. Në këto kohë të vështira pretendimet e tilla i shkaktojnë padrejtësisht dëme të pallogaritshme Republikës së Serbisë dhe reputacionit të BIA-s dhe anëtarëve të saj, që me përkushtim dhe profesionalizëm i kryejnë detyrat e tyre”, thuhet në deklaratë.



## Dëshmitari i tetë i mbrojtjes: Arrestimi i Salih Mustafës, i padrejtë

HAGË, 11 PRILL - Dëshmitari i tetë i mbrojtjes së Salih Mustafës, Kapllan Parduzi, ka përfunduar dëshminë e tij para trupit gjykues në Dhomat e Specializuara në Hagë.

Parduzi ka thënë se arrestimi i Mustafës është i padrejtë sepse nuk ka fakte dhe është i bazuar në sajesa dhe gënjeshtër të dëshmitarëve të rrejshëm dhe Prokurorisë së Serbisë. “Ne konsiderojmë dhe mendojmë se është bërë arrestim i padrejtë, me sajesa... Mendojmë se është i padrejtë sepse nuk ka bazë

dhe nuk ka fakte. Ne mendojmë se të gjitha janë sajesa dhe gënjeshtër të dëshmitarëve të rrejshëm dhe Prokurorisë së Serbisë që, fatkeqësisht, ju e keni dekoruar dhe u keni dhënë dekorata atyre bashkëpunëtorëve të saj që na kanë vlarë dhe djegur dhe na kanë pjekur. Ju me ta keni bashkëpunuar dhe ata i keni dekoruar”, u shpreh ai. Dëshmitari i mbrojtjes së Salih Mustafës intervistimin e tij nga prokurorët e ZPS-së e ka konsideruar joligjor. Më tutje, ai ka thënë se intervistimet

dëshmitarëve të mbrojtjes janë trysni dhe frikë.

Ish-ushtari i UÇK-së, Kapllan Parduzi, gjatë dhënies së dëshmisë nga kryetarja e trupit gjykues është pyetur se intervistimin a e kishte bërë në mënyrë të detyruar po vullnetare. Më pas ai ka thënë se kishte shkuar për ta dhënë dëshminë në zyrat e Prokurorisë Speciale duke menduar se e kanë ftuar për ndonjë informacion lidhur me trupin e zhdukur të axhës së tij, i cili është i zhdukur nga lufta e fundit në Kosovë.



## Pas armatosjes së Serbisë nga Kina, Mehaj: Të reagojnë NATO-ja dhe BE-ja, po minohet paqja në Ballkan

**EPOKA E RE** Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 PRILL - Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës, Armend Mehaj, ka reaguar pasi Serbia ka blerë sisteme raketore nga Kina. “Me blerjen e sistemeve raketore dhe armatimit të ri nga Kina, si dhe sistemeve të mëhershme nga Rusia, rikonfirmohet fuqishëm edhe një herë sjellja destruktive, shumë e rrezikshme dhe antiperëndimore e Serbisë. Sipas informacioneve të dy ditëve të fundit, Serbia ka pranuar nga Kina sisteme të reja të armatimit duke shtuar kontingjentin e saj të mëhershëm të pranuar nga Rusia dhe Bjellorusia”, ka shkruar Mehaj në “Facebook”.

Ai ka thënë se kjo shfaqje e neveritshme po ndodh në kohën kur BE-ja, NATO-ja dhe gjithë bota - pro vlerave euroatlantike - është në përballje me sulmuesin e këtyre vlerave, Rusinë dhe aleatët e saj. “Nga kush rrezikohet Serbia, apo kundër



kujt armatohet Serbia me sistemet më të avancuara sulmuese dhe mbrojtëse? Ç’është kjo hipokrizi? Deri kur me këto standarde të dyfishta? Republika e Kosovës, institucionet e sigurisë dhe mbrojtjes si dhe ne, populli paqedashës dhe liridashës, kemi

shprehur në vazhdimësi shqetësimin e arsyeshëm, si dhe në vazhdimësi kemi reaguar për këtë qasje destruktive dhe të rrezikshme të Serbisë ndaj paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon dhe më gjerë”, është shprehur ai.

Mehaj në vazhdim ka kërkuar

nga autoritetet e vendimmarrjes së NATO-s, BE-së dhe OKB-së, si dhe të gjitha instancat e tjera të politikëbërjes pro vlerave të paqes, lirisë dhe demokracisë të shqyrtojnë me seriozitetin maksimal këtë qasje destruktive dhe të rrezikshme të Serbisë që ndikon seriozisht në minimin e

paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë. “Republika e Kosovës, institucionet dhe populli ynë, jemi të vendosur dhe e kemi dëshmuar fuqishëm orientimin tonë euroatlantik me aspiratën e natyrshme për anëtarësim sa më të shpejtë në NATO dhe BE. Këtë e kemi konfirmuar çdoherë, por edhe tani, ku përkrah aleatëve tanë të udhëhequr nga ShBA-ja, vazhdojmë procesin e ndërtimit dhe zhvillimit të ushtrisë sonë dhe të gjitha institucioneve të tjera shtetërore sipas praktikave dhe modeleve më bashkëkohore të demokracive perëndimore. FSK-në - ushtri të fuqishme profesionale në mbrojtjen e vendit dhe në shërbim të paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal, kontinental dhe global. Ky është misioni ynë dhe ky është interesi ynë jetik shtetëror e kombëtar. Për këtë jemi të pandalshëm, të pakthyeshëm dhe të pathyeshëm”, ka thënë ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj.

## Komuna e Prishtinës kërkon bashkëpunim nga të gjitha institucionet për zgjidhjen e problemit të qenve endacakë



PRISHTINË, 11 PRILL - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka thënë të hënën se me shqetësim ka parë pamjet, ku një qytetare e Prishtinës sulmohet nga qentë endacakë. “Ne jemi të vetëdijshëm për problemin

shumë kompleks që kemi para vetes dhe në këtë drejtim kemi ndërmarrë disa veprime, si trajtimin e qenve endacakë përmes procesit KSVL (Kap, Sterilizo, Vaksino, Lësho) dhe hapjen e 18 pikave të reja

ushqyese. Gjithashtu, po punojmë dhe kemi filluar procedurat për ndërtimin e strehimores për qentë. Por, kjo nuk mjafton për ta eliminuar në tërësi këtë problem”, ka thënë Rama, duke shtuar se ky

problem kompleks nuk mund të zgjidhet vetëm nga komuna e Prishtinës, andaj ka kërkuar bashkëpunim dhe bashkërendim të veprimeve edhe me Qeverinë e Kosovës dhe komunat e tjera.

## 14 raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 11 PRILL - Ministria e Shëndetësisë, sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, ka informuar se pas 708 testimeve, 14 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit nuk

është shënuar asnjë rast i vdekjes.

Të hënën janë shëruar 24 qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 224 085. Në total numri i rasteve aktive është 534.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 12 doza të vaksinës kundër Covid-19.

Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 821 690 doza të vaksinës.

Deri më sot 821 084 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 100 583 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.



# Qeveria ka afat edhe dhjetë ditë për shqyrtimin e propozimit për tërheqjen e kursimeve nga Trusti

PRISHTINË, 11 PRILL - Qeverisë së Kosovës i kanë mbetur edhe dhjetë ditë afat për shqyrtimin e propozimit të PDK-së, në këtë rast për kërkesën e kryesisë së Kuvendit të Kosovës për ndryshimet ligjore që u mundësojnë qytetarëve tërheqjen e një përqindjeje nga Trusti i Kursimeve Pensionale. Nëse ekzekutivi nuk i përgjigjet Kuvendit, kjo iniciativë nga deputeti i partisë më të madhe opozitare, Bekim Haxhiu, hyn në procedurë parlamentare. Kryesia e Kuvendit më 21 mars ka proceduar kërkesën në qeveri dhe afati për shqyrtim është një muaj. Nga Qeveria dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve nuk kanë treguar se kur pritet t'i kthehet një përgjigje Kuvendit lidhur me këtë çështje. Megjithatë, ish-ministri i Financave, Haki Shatri, mendon se do të ishte veprim i gabueshëm dhe i dëmshëm edhe një tërheqje e kursimeve nga

Trusti. Shatri thekson se qeveria ka alternativa të tjera për t'u dalë në ndihmë qytetarëve. Ai ka kërkuar veprime urgjente nga ekzekutivi për ta zbutur te qytetarët, siç thotë ai, ndikimin e madh të ngritjes së çmimeve për prodhimet ushqimore. Sipas tij, tërheqja e kursimeve nga Trusti ka efekte negative për qytetarët. Ai thekson se përfituesit kryesorë do të jenë tregtarët duke ngritur çmimet në vazhdimësi. "Aleanca e ka përkrahur, mirëpo jo pa rezervë, jo pa asnjë vërejtje, për tërheqjen e 30 për qind të mjeteve të fondit, sepse nëse janë 2 miliardë e 200 milionë euro në Trust, 30 për qind, i bie mbi 600 milionë euro, që është një shumë e madhe. Kjo mund të paraqesë problem, sepse këto mjete janë të plasuar në institucionet financiare ndërkombëtare, janë të afatizuara. Pra duhet të kemi kujdes për stabilitet dhe siguri të mjeteve të Trustit, sepse ato janë



para të qytetarëve në mirëbesim", thotë Shatri. Ish-ministri Shatri po kërkon nga qeveria veprime urgjente për

krizën në vend të shkaktuar nga inflacioni i lartë prej 7.5-përqindësh. Krahas shtrenjtimit të madh të naftës, bukës, vajit dhe

prodhimeve të tjera, Shatri ka kërkuar uljen e akcizës për naftë dhe heqjen e TVSh-së për artikujt e domosdoshëm për qytetarët.

## BB: Ekonomia e Ukrainës gati se do të përgjysmohet



WASHINGTON, 11 PRILL - Ekonomia e Ukrainës parashikohet të përgjysmohet këtë vit për shkak të pushtimit rus, i cili ka shkatërruar fabrika dhe ndërtesa të mëdha banimi, si dhe ka detyruar miliona njerëz të largohen nga vendi, thuhet në një raport të Bankës Botërore. Sipas tij, prodhimi ekonomik i Ukrainës pritet të tkurret për 45 për qind, ndërsa shkalla përfundimtare e rënies ekonomike do të varet nga "kohëzgjatja dhe intensiteti i luftës". "Pushtimi rus po i jep

një goditje masive ekonomisë së Ukrainës dhe ka shkaktuar dëme të mëdha në infrastrukturë", tha Anna Bjerde, nënkryetare e Bankës Botërore për rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore. Rusia ka shkatërruar Mariupolin, një port kyç i Ukrainës në Detin Azov, dhe ka dëmtuar rëndë qytetet e tjera të mëdha, duke përfshirë Harkivin, qytetin e dytë më të madh të Ukrainës për nga popullsia. Rusia ka bombarduar,

gjithashtu, aeroporte dhe linja hekurudhore, ndërsa shumë ura janë hedhur në erë. Më shumë se 10 milionë ukrainas, ose gati një e katërta e popullsisë, besohet se janë larguar nga shtëpitë e tyre, përfshirë më shumë se 4 milionë që kanë kaluar kufijtë e Ukrainës. Në një raport, Banka Botërore tha se ekonomia e Rusisë pritet të tkurret për 11 për qind këtë vit si pasojë e sanksioneve që i ka vënë Perëndimi për shkak të pushtimit të Ukrainës.

## Rubla ruse vazhdon të zhvlerësohet



MOSKË, 11 PRILL - Rubla është dobësuar ndjeshëm pas vendimit të Bankës Qendrore të Rusisë për të hequr disa masa të përkohshme të cilat kanë pasur qëllim parandalimin e zhvlerësimit të valutës vendore. Masat kanë nisur të zbatohen pas vendosjes së sanksioneve të komunitetit ndërkombëtar ndaj Moskës për agresionin ushtarak në Ukrainë. Banka Qendrore ka thënë se do ta heqë masën e komisionit prej 12-përqindësh për blerjen

e valutave të huaja nga 11 prilli. Po ashtu, banka ka thënë se do të pezullojë një ndalesë të përkohshme për shitjen e parave të këmbimit prej 18 prillit. Valuta ruse ka rënë në 82.09 kundrejt dollarit amerikan më 11 prill, për dallim nga 71 rubla sa ka qenë më 8 prill. Mbështetja kryesore për rublën, pas sanksioneve, ka qenë nga konvertimi i detyrueshëm i 80 për qind të të ardhurave valutore nga

kompanitë e fokusuar në eksport, si dhe nga normat e larta të interesit, edhe pse Banka Qendrore ka ulur papritur normën e saj bazë nga 20 për qind në 17 për qind javën e kaluar. Më 24 shkurt presidenti rus Vladimir Putin ka urdhëruar atë që e konsideron "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Veprimi i Kremlinit ka nxitur zemërim dhe është dënuar në shumë vende të botës.

## Çmimet e naftës në Gjermani, ndër më të lartat në Evropë

BERLIN, 11 PRILL - Çmimet e naftës në Gjermani tani janë ndër më të lartat në Evropë. Në Bashkimin Evropian çmimet lokale të naftës janë më të larta vetëm në Finlandë

dhe Suedi, sipas të dhënave të publikuara nga Zyra Federale e Statistikave në Gjermani. Të dhënat zyrtare tregojnë se çmimi për një litër naftë në Gjermani shkon në 2.06 euro.

Kjo shifër është më e lartë për 45 centë sesa në shtetin fqinj, Poloni. Çmimi i naftës në Luksemburg është 1.76 euro centë, 1.84 euro në Austri dhe

1.89 euro centë në Francë. Çmimet më të ulëta të naftës, brenda Bashkimit Evropian, janë në Maltë, 1.21 euro për litër dhe në Hungari, 1.42 euro.



# Premtimi dhe marrëzia e luftës: Pse liderët hyjnë në një konflikt, duke supozuar se fitorja është e garantuar?

**Nga Gregory A.DADDIS**

Në kushtet e një mbrojtjeje të vendosur dhe pasionante, që e ka ngadalësuar ndjeshëm përparimin e rusëve drejt Kievit dhe kur luftë është denoncuar thuajse nga e gjithë bota, ka pasur shumë spekulimeve mbi motivet që e nxitën Vladimir Putini: Çfarë shpreson të arrijë ai me luftën në Ukrainë?

Disa kanë argumentuar se Putini po kundërpërgjigjet ndaj zgjerimit të NATO-s, apo se është i nxitur nga një ndjenjë e fortë e nacionalizmit rus. Të tjerë thonë se ai pa një shans të mirë për të ringjallur në Evropën Lindore ndikimin sovjetik të Luftës së Ftohtë. Ekspertë dhe analistë të tjerë pretendojnë se ai është thjesht një lider delirant, një oligark që ka humbur lidhjet me realitetin. Por sikur vendimi i Putinit për të pushtuar vendin fqinj të jetë bazuar pjesërisht në një supozim të përhapur, se luftërat sulmuese të zgjedhura vetë, më së shumti japin një rezultat pozitiv?

Këtu vlen të analizohet nëse kjo luftë ka të bëjë po aq me çështjet lokale dhe rajonale, mbi atë se kush e kontrollon rajonin e Donbasit në Ukrainën Lindore, po aq sa ka të bëjë edhe me një besim të padiskutueshëm se përdorimi i forcës së armatosur, është rruga më e sigurt për arritjen e qëllimeve politike.

Disa analistë të politikës së jashtme amerikane, si Xhon Marshajmer i Universitetit të Çikagos, pretendojnë se mbështetja e SHBA-së për zgjerimin e NATO-s drejt lindjes, është po aq e rëndësishme në shpjegimin e krizës aktuale në Ukrainë. Por si një historian ushtarak që ka shërbyer për 26 vjet në ushtrinë amerikane, unë besoj se një pyetje më themelore, është se përse politikë-bërësit, dhe jo vetëm në Rusi, kanë kaq shumë besim tek lufta, edhe kur llogaritjet e gabuara më të vogla, mund të çojnë shumë lehtë drejt katastrofës.

Premtimet që sjell një luftë, i kanë joshur udhëheqësit politikë dhe ushtarakë për mijëvjeçarë. Historiani athinas Tukididi, foli shumë

shpesh për qytet-shtetet greke të motivuara për luftë nga nderi dhe përfitimi, por edhe nga frika që kishin nga armiqtë e tyre.

Afro 2200 vjet më vonë, Etërit Themelues të Amerikës e panë luftën si mënyrën më të sigurt për t'u shkëputur nga kontrolli perandorak britanik, për të krijuar një identitet të ri, të çliruar nga ndikimi i jashtëm, dhe për të krijuar një komb sovran.

Përfitimet e një lufte mund të jenë të shumta: pavarësi, fuqi e shtuar, territore dhe burime të reja. E megjithatë, për çdo sukses ushtarak, të dhënat historike ofrojnë raste të shumta kur ato kanë shkuar keq.

Për shembull Napoleoni mund të ketë qenë në prag të kontrollit thuajse total të Evropës në fillim të viteve 1800. Por i njëjti instrument i ushtrive të mëdha pushtuese që e ngjiten atë në një nivel të tillë, siguroi edhe rënien e tij kur përdorej nga një koalicion i fuqive rivale kontinentale.

Në dy luftëra botërore një shekull më vonë, udhëheqësit gjermanë parashikuan një rend të ri botëror të garantuar nga fitoret e mëdha ushtarake. Megjithatë ato konflikte shkaktuan dhjetëra miliona të vdekur në mbarë botën, dhe një Gjermani të mundur dy herë që kërkon shpagim dhe një rëndësi të re gjatë Luftës së Ftohtë.

Gjatë dekadave të pas Luftës së Dytë Botërore, forcat ushtarake franceze do të përballeshin me disfata në Indokinë dhe Algjeri. Amerikanët do të kishin një fat të ngjashëm në Vietnamin e Jugut, ndërsa sovjetikët në Afganistan.

Por çfarë e bën luftën të duket sikur ia vlen, pavarësisht rreziqeve të pashmangshme? Ndoshta është bindja se fitorja e armatosur, është faktori më vendimtar në çdo arenë të politikës ndërkombëtare. Gjatë epokës së Luftës së Ftohtë, udhëheqësit sovjetikë nga Josif Stalini tek Leonid Brezhnjevi, u mbështetën te lufta dhe kërcënimi i saj për të konkurruar globalisht me Shtetet e Bashkuara.

Në terma praktik, inkursionet brutale ushtarake sovjetike në



Hungari në vitin 1956 dhe Çekosllovakia në vitin 1968, dukeshin si mjetet më efikase për t'i mbajtur satelitët e Evropës Lindore brenda orbitës së Paktit të Varshavës. Dhe duket se Putin i ka parë sukseset e tij të fundit në Çeçeni, Gjeorgji dhe Siri, si një pararojë e fitores në Ukrainë.

Por përkulja e “muskujve ushtarakë” e ka një kosto. Vendosja e raketave sovjetike në Kubë në fillimin e viteve 1960, e solli botën në pragun e luftës bërthamore. Kostot e mbajtjes së një ushtrie dhe marine gjigante gjatë Luftës së Ftohtë, e dobësuan shumë një ekonomi sovjetike tashmë të paqëndrueshme.

Dhe nuk ka asnjë diskutim, se lufta e gjatë në Afganistan kontribuoi në rënien përfundimtare të perandorisë sovjetike, ndërsa vetë Lufta e Ftohtë po i afrohej fundit. Atëherë çfarë perspektive pozitive mund të ofrojë nga ky përkushtim ndaj premtimit të luftës?

Së pari, këtu kanë rëndësi aspektet morale të luftërave që zgjidhen të zhvillohen. Siç pretendon filozofi Majkëll Valzer, ekziston shpesh një vijë shumë e hollë midis luftërave

sulmuese të zgjedhura dhe akteve kriminale të agresionit.

Po ashtu supozimi se lufta është një forcë transformuese, që sjell ndryshime politike dhe sociale, nuk është vërtetuar gjithmonë. Kur administrata e Xhorxh W. Bush vendosi të pushtonte Irakun në vitin 2003, këshilltarët e tij kryesorë panë një shans për të transformuar qeverisjen dhe shoqërinë irakiane.

Megjithatë, udhëheqësit lokalë u treguan shumë më rezistent ndaj ndryshimeve të jashtme nga sa e parashikuan këta politikë-bërës, gjë që ndodhi edhe në luftërat në Afganistan dhe Vietnam. Edhe në Ukrainë, Putini duket e ka llogaritur gabim forcën e opozitës lokale.

Në fakt, shumë konflikte moderne, kanë treguar se fitorja nuk arrihet shpejt dhe me një kosto të ulët.

Në fund të presidencës së tij, Duajt D. Ajzenhauer këshilloi për kostot e fshehura të një kompleksi ushtarak-industrial që ushqente një gjendje të qëndrueshme lufte. Dhe duket se ai kishte të drejtë. Projekti “Kostot e Luftës” në Universitetin Braun llogariti se Pentagoni ka shpenzuar “mbi 14 trilionë dollarë që

nga fillimi i luftës në Afganistan, 30 për qind deri në 50 për qind të totalit që u është dhënë kontraktorëve ushtarakë”. Në atë luftë humbën jetën rreth 47.000 civilë afganë dhe më shumë se 6.000 anëtarë të forcave amerikane dhe kontraktorë. E gjitha kjo ngre një pyetje të arsyeshme nëse ia kanë vlejtur përfitimet nga këto luftëra duke pasur parasysh kostot e jashtëzakonshme financiare dhe njerëzore. Ndërsa bota ndjek tragjedinë që po shpalolet në Ukrainë, besoj se është e rëndësishme të merret parasysh premtimi konstant, por i gabuar i luftës.

Ndoshta historia e Athinës mund të jetë një pikënisje shumë e mirë për t'i filluar. Siç paralajmëroi edhe historiani grek Tukididi, “Është një gabim i zakonshëm kur shkohet në luftë me idenë për t'ia filluar nga fundi i gabuar, duke u hedhur në fillim në veprim, duke pritur të ndodhin fatkeqësitë, për t'u ulur pastaj në bisedime”.

Shënim: Gregory A. Daddis, profesor i historisë moderne ushtarake të SHBA-së në Universitetin Shtetëror të San Diegos. /

“The Conversation” – Bota.al



# Jul Çezari, mitet dhe të vërtetat mbi perandorin e famshëm romak



Një politikan i fuqishëm, gjeneral ushtrie dhe perandor, Jul Çezari ndihmoi në shndërrimin e Romës në një nga perandoritë më të fuqishme në histori. Ai ishte një udhëheqës i dashur nga shumë njerëz. Por fuqia e tij shkaktoi gjithashtu shumë pakënaqësi tek kolegët e tij politikanë. Ja çfarë duhet të dini rreth jetës së Çezarit, lidhjes që ai pati me Kleopatrën, vrasjen, dhe dramën e famshme të Uilliam Shekspir, që ndihmoi në përjetësimin e figurës së tij: Ka lindur më 12 ose 13 korrik të vitit 100 Para Erës Sonë, por ka të ngjarë jo përmes “prerjes çezariane”

Për shekuj me radhë, është besuar se Jul Çezari ishte fëmija i parë i lindur përmes “prerjes çezariane”. Por kjo gjë ka të ngjarë të jetë larg së vërtetës. Burimi i kësaj ngatërrese mund të jetë një enciklopedi historike bizantino-greke e shekullit X-të e quajtur Suda.

Ajo pretendonte se prerjet çezariane e kanë marrë emrin e tyre nga vetë Çezari: “Perandorët e romakëve e marrin këtë emër nga Jul Çezari, që nuk kishte lindur në mënyrë natyrale. Nëna e tij vdiq në muajin e nëntë të shtatzanisë. Ndaj njerëzit u detyruan t'i hapin barkun duke e nxjerrë jashtë fëmijën. Dhe në gjuhën romake kjo lloj prerjen quhet “çezariane”.

Por kjo nuk ka të ngjarë të ketë ndodhur për disa arsye. Së pari, prerjet çezariane ishin kryer tashmë në Romë në atë

kohë. Një ligj që kërkonte kryerjen e prerjeve çezariane në rrethana të caktuara, u miratua gjatë mbretërimit të Numa Pompilius, që sundoi në vitet 715-673 Para Erës Sonë, pra shumë kohë përpara Jul Çezarit.

Sipas ligjit, nëse një grua vdiste gjatë shtatzënisë, ajo duhej t'i nënshtrohej një prerje çezariane, pasi ishte kundër besimeve romake varrosja e një nënë me foshnjën e saj në bark. Ligji parashikonte që edhe gratë shtatzëna që ishin duke vdekur t'i nënshtroheshin një procedure të tillë, në përpjekje për të shpëtuar jetën e foshnjës. Suda shkruan gabimisht se nëna e Çezarit, Aurelia, vdiq gjatë lindjes. Ndërkohë dihet që jetoi mirë deri në moshë të thyer.

## Drama e Shekspir “Jul Çezari” la jashtë një protagonist kyç në vrasjen e perandorit

Drama e Uilliam Shekspir, i zhvillon ngjarjet në vitin 44 Para Erës Sonë. Ajo përshkruan motivet që çuan në vrasjet e tij dhe pasojat e këtij akti. Një nga citatat më të famshme nga drama, e thënë nga Çezari pak para vdekjes së tij është “Et tu, Brute? (Edhe ti Brut?).

Në fakt Çezari nuk e tha këtë, pasi ai as që e njihte aq mirë Brutin. Tradhtari i vërtetë është Decimus Junius Brutus Albinus. Por ai përmendet shumë pak në dramë dhe emri i tij ishte shkruar gabimisht. Në fakt, ai ishte miku i Çezarit.

Madje, perandori e përfshiu në politikë për ta ndihmuar në rivendosjen në vend të imazhit të familjes së tij. Madje ata luftuan përkrah njëri-tjetrit në betejat. Por në fund, Decimus luajti një rol kyç në atentatin ndaj Çezarit.

## Jul Çezari dhe Kleopatra patën një lidhje midis tyre që solli në jetë një djalë të quajtur Çezarion

Lidhja midis Çezarit dhe Kleopatrës ishte më shumë se sa epi. Ajo ishte një marrëdhënie, që të dyve u duhej për të arritur synimet e tyre. Që Kleopatra të siguronte pozitën e saj në fronin e Egjiptit, i duhej një ushtri. Më saktë, ajo kishte nevojë për ushtrinë e madhe të Çezarit. Këtij të fundit i interesonte pasuria e madhe për të shlyer borxhet e perandorisë, duke çimentuar pozicionin e tij në pushtet.

Kleopatra shkoi të jetonte në Romë me Çezarin. Ata patën së bashku një djalë, Çezarionin. Shfaqjet publike të dashurisë së Çezarit, frymëzuan edhe ngritjen e një statuje të Kleopatrës në Tempullin “Venus Genetrix”. Ajo mbeti më Romë deri në vrasjen e Çezarit, ngjarje që e detyroi të largohej bashkë me djalin.

U vra më 15 marsin e vitit 44 Para Erës Sonë, pasi u godit 23 herë me thikë. Në vitin 44 Para Erës Sonë, Çezari e shpalli veten diktator të përjetshëm. Ndërsa shumë nga ndryshimet dhe reformat e tij u pritën mirë nga

popullata e shtresës së ulët dhe të mesme, politikanë u shqetësuan nga fuqia e tij gjithnjë në rritje. Ndaj perandori u godit me thikë për vdekje nga një grup prej rreth 40 senatorësh.

## Ju mund të vizitoni vendin ku u vra Jul Çezari

“Largo di Torre Argentina” është sheshi më i vjetër i Romës në ambient të hapur, dhe ishte vendi ku Çezari u godit 23 herë me thikë më 15 marsin e vitit 44 Para Erës Sonë. Ai u shkatërrua gradualisht gjatë shekujve në vijim. Por pas një restaurimi me vlerë 1.1 milionë dollarë, ky sit historik është i hapur për publikun që nga viti i kaluar.

## Një bust që mendohet se i përket Jul Çezarit u zbulua në vitin 2007

Disa historianë dhe arkeologë, besojnë se një bust i nxjerrë nga lumi Ron në Francë në vitin 2007, është në fakt i Jul Çezarit. Nëse kjo është e vërtetë, do të ishte e vetmja statujë e mbijetuar e realizuar për perandorin gjatë kohës që ai ishte gjallë. Meqë shumica e paraqitjeve vizuale të Çezarit u bënë pas vdekjes së tij, historianët thonë se ato priren të jenë versione të idealizuara të tij. Por ky bust mendohet se i ngjan liderit ashtu siç dukej realisht, duke treguar një vijë flokësh që tërhiqet pas kohës, dhe rrudha

të shumta në ballë. Përmendorja ndodhet aktualisht në Musée Departmental de l'Arles Antique.

## U rrëmbye nga piratët, por më vonë u hakmor ndaj tyre

Kur ishte 25 vjeç, Çezari po lundronte me një anije në detin Egje, teksa u rrëmbye nga piratët siçilianë. Ata do të kërkonin 20 talenta argjendi (rreth 600.000 dollarë sot) për lirim të tij. Thuhet se Çezari qeshi në mënyrë ironike dhe u tha se duhej të kërkonin 50 talenta (rreth 1550 kg argjend). Kur bashkëpunëtorët e tij shkuan të merrnin paratë, Çezari u detyrua të prishte në robëri. Kur u lirua, ai mbledhi një grup të vogël ushtarësh, i gjeti piratët, ua preu fytin dhe ua mori argjendin.

## Pati 3 gra gjatë jetës së tij

Çezari u martua me Kornelian, gruan e tij të parë, në vitin 84 Para Erës Sonë. Ata patën një vajzë së bashku, por Kornelia vdiq në vitin 69. Dy vite më vonë, Çezari u martua me Pompeian, nga e cila më vonë u divorcua. Më pas u martua me Kalpurnian në vitin 59, dhe jetuan së bashku deri në vdekjen e tij.

## Thënie të famshme të Jul Çezarit:

“Erdha, pashë, fitova” ose në latinisht “Veni, Vidi, Vici”.

“Njerëzit e besojnë me dëshirë atë që e dëshirojnë”.

“Nëse duhet të shkelni ligjin, bëjeni këtë për të marrë pushtetin: në të gjitha rastet e tjera respektojeni atë”.

“Askush nuk është aq i guximshëm sa të mos shqetësohet nga diçka e papritur”.

“Unë e dua tradhtinë, por e urrej tradhtarin!”.

Thënie të famshme nga drama “Jul Çezari” e Uilliam Shekspir “Frikacakët vdesin shumë herë para vdekjes së tyre; të guximshmit e përjetojnë vetëm njëherë vdekjen”.

“Vdekja, një fund i domosdoshëm, ajo do të vijë kur të jetë koha”.

“Kujdes nga Idet e Marsit”. (e thënë nga një fallxhore) / bota.al

# Legjenda për Judën e lindur në Butrint!



## Nga: Moikom ZEKO

Arkeologu italian Ugolini, ka regjistruar një legjendë të çuditshme që ka mbijetuar te shqiptarët në Jug të Shqipërisë. Legjenda vjen nga Mesjeta, të paktën nga shekulli XII. Sipas saj, Juda, apostulli dhe tradhtari i Krishtit, gjoja paska lindur në Akropolin e Butrintit.

Ky besim i çuditshëm dhe fantazmagorik, ndoshta e ka prejardhjen nga një keqkuptim i natyrës topografike, pra është një lloj kakofonie. Në ishullin e Korfuzit ka një fshat që quhet Skaria (ndoshta emri homerik i Korfuzit). Banorët quhen skariotë – nga Skarioti te Iskarioti rruga e ngatërrimit është tepër e ngushtë, por edhe e lehtë. Por, banorët e Korfuzit nuk kanë dashur ta kenë “këtë lavdi të palavdishme”. Dhe, thonë se vendlindja e Judës ka qenë Butrinti.

Që kjo legjendë nuk është shpikje mendore e kohërave moderne, apo një kuriozitet i thugët, del qartë

nga fakti se luftëtarët e Kryqëzatës së IV-të (viti 1204) e dinin këtë gojëdhënë të nëmur, që përmendet edhe nga abati benediktin i Piterborosë, në veprën e tij “Bëmat e Mbretit Henriku i Dytë”. Zanafilla e gojëdhënës është shumë më e vjetër se shekullin XIII. Kjo do të thotë që në shekullin XII kjo histori e paragjykuar qe gati një traditë e besueshme, e gatshme, një material për të ndërtuar struktura fantazish, të përshtatshme për kryqtarët.

Nuk dihet dhe nuk mund të shpjegohet pse lindi miti, se Butrinti qe vendlindja e Judës. Kjo është në kundërshtim të plotë me informacionin e katër ungjijve sinoptikë. Ndoshta buron nga ndonjë ungjill apokrif? Ndoshta kultura gnostike ka gëluar këtu në Antikitin e Vonë dhe në Mesjetën e Hershme?

Dihet se një komunitet hebrejsh ka jetuar në rrethinat e Vlorës dhe emri qytetit Orikum u quajt prej tyre me emrin e qytetit biblik Jeriko. Kjo ngatërresë

qe thjesht e qëllimshme, apo metaforike? Kemi të bëjmë këtu me shtegtimin e toponimeve, të emër-vendeve, dukuri kjo e rëndomtë në kohë dhe në hapësirë? Pse këto mite vendase dhe lokale, të brumëzuara nga krishterimi vërtiten dhe përhapen përqark? Pse Butrinti, qyteti virgjilian i Eneut, që u lartësua në kohën e Oktavian Augustit u quajt si vendlindja e nëmur e Judës?

Ungjijtë thonë saktësisht se Juda u vetëvar në një vend të caktuar në Jerusalem. Juda qe flokëkuq, puthja e tij e famshme e identifikimit ka mbetur një shëmbëlltëre letrare dhe proverbiale e të gjithë kohërave. 40 asprat e argjendta nuk janë për të paguar kalimin e tij me barkën e Karontit në Had, janë pengu i tij i çmendurisë dhe i mosmirënjohjes më të skajshme. Vetëm Borgesit në një tregim të pabesueshëm dhe të llahtarshëm, të quajtur “Tri interpretimet e Judës”, shkruan se gjoja Nils Runebergu, një studiues i çmendur po edhe

mendjemprehtë, anëtar i një bashkësie evangjeliste, shkroi një vepër ku rreket të vërtetohet se Juda e kish tradhtuar Jezu Krishtin që ta detyronte, ta shpallte hyjninë e tij dhe t’i jepte zjarr revoltës kundër shtypjes romake.

Juda, i vetmi ndër apostujt, kishte parandjerë hyjninë e mistershme dhe qëllimin e zjarrtë të Krishtit. Fjala ishte përulur që të bëhej fjalë e vdekjes, Juda, nxënësi i Fjalës, mund të përulej dhe të bëhej denoncues (më e keqja, që e përmban një çnderim) dhe të hynte në zjarrin, që nuk shuhej. Sistemi i poshtëm është pasqyrë e më të lartit, trajtat e Tokës përputhen me trajtat e Qiellit, njollat e lëkurës së Judës qenë hartë e yjësive të amshueshme, në një farë mënyre Juda ishte shkëlqimi i personalitetit të Krishtit.


Nils Runebergu u mbështet në motivin e asketizmit të tepërt, madje të skajshëm. Asketi e damkos dhe e mundon trupin e vet për të arritur famë sa më të madhe te Zoti. Juda po ashtu kishte bërë me shpirtin e tij. Kishte

hequr dorë nga nderi, mirësia, mbretëria qiellore. Ai që më parë se të tjerët me fuqi parashikuese i kishte parashikuar mëkatet e veta. Në shkeljen e kurorës zakonisht kemi butësi dhe therrori, në vrasje – guxim, në profanizim dhe blasfemim të Zotit – një xixë të satanizmit. Juda i kishte zgjedhur mëkatet që në vetvete nuk ngërthenin asgjë nga virtyti. Këtu shpjegohet keqpërdorimi i besimit dhe denoncimi. Veprimi me përunjësi të rrallë, veten e konsideroi të padenjë të jetë i mirë. Juda e synoi Ferrin se për të ishte e mjaftueshme fama e Zotit. Ky arsyesim borgesian të çmend dhe të çmerit, është më tepër eksperiment mendor.

Por, kryqtarët e Mesjetës ishin akoma të paditur dhe të paafët për të arritur tek Borgesi. Kështu ata besuan me tërë mend një keqkuptim shqiptar dhe gati kozmik se Butrinti qe vendi ku lindi Juda i neveritshëm. Shumë e lodhshme dhe e papritur kjo histori! Nuk kam fuqi dhe as shpresë ta vazhdoj më tutje.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Envert

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com




**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82



## Penza triumfon në finalen e parë

PRISHTINË, 11 PRILL - KBF Penza ka shënuar fitore në finalen e parë të "play-off"-it në Superligën e femrave, duke mundur Prishtinën në udhëtim 58:76 (14:8, 14:25, 11:22, 19:21). Ndeshja e dytë zhvillohet në Pejë, ndërsa kampion shpallet skuadra që arrin tri fitore. Prishtinaset e nisën ndeshjen më mirë, duke

pasur epërsi të lehtë, që e ngritën në fund të çerekut të parë, ku këtë pjesë e fituan 14:8. Pejanet rikthehen shpejt në periudhën e dytë, duke barazuar rezultatin në 21:21, e më pas zhvillohet lojë e barabartë, ndërsa në fund të kësaj pjese mysafirët ishin më të mira, duke shkuar në pushim me rezultat 28:33. Në

periodën e tretë kampionet e Kosovës ishin më të mira, duke ngritur epërsinë në këtë pjesë edhe më shumë, ndërsa shifrat në semafor pas 30 minutash ishin 39:55. Në dhjetë minutat e fundit, Penza ngriti edhe më shumë epërsinë, duke shkuar drejt fitores së sigurt, gjë që edhe ndodhi dhe fituan me rezultat 58:76.



©KBF Prishtina

## Andersen: Ndaj Belgjikës nuk është lehtë por besoj në paraqitje të mirë

PRISHTINË, 11 PRILL - Përfaqësuesja e Kosovës në konkurrencën e femrave ka zhvilluar stërvitjen e fundit para ndeshjes me Belgjikën, të vlefshme për kualifikimet e Kampionatit Botëror 2023. Kjo ndeshje zhvillohet sot (e martë) në stadiumin "Fadil Vokrri" në orën 20:00. Përzgjedhësja e re e Kosovës, Karin Anneli Andersen e sheh si përballje të vështirë ndeshjen ndaj Belgjikës, megjithatë beson se Kosova do të bëjë paraqitje të mirë pavarësisht kohës së shkurtër në dispozicion për t'u përgatitur. Andersen ka thënë se është munduar t'i përfshijë sa më shumë lojtarët dhe t'i gjejë pozicionet e tyre në mënyrë që futbollistët të ndihen më mirë në fushë dhe të japin maksimumin e tyre. Ajo ndër të tjera ka deklaruar se ka ardhur të



punoj dhe bashkërisht t'i arrijmë objektivat tona. "Unë e kam parë se ka futbolliste shumë të talentuara por që edhe duhet të punojmë më shumë si në aspektin individual edhe në atë grupor", ka thënë trajnerja suedeze. Në anën tjetër futbollistët Donjeta Halilaj

dhe Erëleta Memeti, treguan për atmosferën e mirë të ekipi i Kosovës, teksa ndeshjen ndaj Belgjikës e konsideruan aspak të lehtë duke pas parasysh eksperiencën e tyre. Megjithatë "Dardanët" pohuan se do ta japin maksimumin për Kosovën.

### SHKURT

#### Kosova mposhti Turqinë

Basketbollistët e Kosovës kanë shënuar fitore ndaj Turqisë me rezultat 58:48 (15:12, 3:12, 20:6, 20:18), në turneun e FIBA YDF-së për U14, që po mbahet në Therandë. "Dardanët" e rinj e nisën ndeshjen më mirë, duke qenë në epërsi konstante në çerekun e parë, që e fituan 15:12. Por, në periudhën e dytë, mysafirët ishin më të mirë, ndërsa basketbollistët e Kosovës kishin probleme në sulm, duke bërë që për dhjetë minuta të shënojnë tri pikë, ndërsa pjesa e parë përfundon 18:24. Vendasit rikthehen shumë shpejt, për të barazuar rezultatin në 29:29, e më pas kontrolluan lojën, për të ngritur epërsinë, ndërsa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 38:30. Dhjetë minutat e fundit ishin shumë interesant, ku Turqia nuk dorëzohet dhe ngushton shifrat në 50:48, por pa arritur të bëjë më shumë dhe Kosova triumfoi me rezultat 58:48. "Dardanët" përfunduan garat me tri fitore e një humbje.

#### 'Dardanët' humbin në ndeshjen për vendin e parë

Përfaqësuesja e Kosovës në futsall e ka mbyllur me humbje rrethin e parë të kualifikimeve për Kampionatin Botëror për vitin 2024. Në ndeshjen e fundit të Grupit C, Kosova pësoi nga Armenia, me rezultat 2:1. Kësisoj, pozita e parë në grup i takoi armenëve, me 9 pikë, derisa Dardanët e mbyllën këtë rreth në pozitën e dytë me 6 pikë. Të dy këto kombëtare e siguruan kualifikimin në rrethin e ardhshëm të kualifikimeve (Main Round). Armenia krijoi epërsi prej dy golash qysh në minutat e para. Fillimisht, në minutën e dytë Melos Kelmendi shënoi autogol, derisa gjashtë minuta më vonë epërsinë e dyfishoi Vitinho. Ndërkaq, më pas përkundër përpjekjeve të vazhdueshme, Kosova nuk arriti të bëjë përmbysjen e rezultatit, duke u mjaftuar me golin e Melos Kelmendit në minutën e 20-të.

#### Reali arrin marrëveshje me Mbappen

Real Madridi ka arritur marrëveshje verbale për të nënshkruar me Kylian Mbappen, si lojtar i lirë në afatin kalimtar të verës. Siç raportohet nga gazetari i njohur Gianluca Di Marzio, Real Madridi i ka ofruar një kontratë prej 50 milionë euro bruto, 25 milionë euro neto në sezon. Gjithashtu për të nënshkruar do t'i ofrohen 100 milionë euro francezit. PSG-ja po punon për rinovimin e tij me synimin që ai të mos shkojë falas në muajt në vijim, me një ofertë edhe më të lartë ekonomike, por gjithçka duket se tregon se francezi do të largohet nga vendi i tij për të luajtur në kryeqytetin spanjoll për sezonin e ardhshëm. Ka vetëm dy skenarë të mundshëm. Asgjë nuk mund të përjashtohet për momentin, por nuk është sekret për askënd që Mbappe menaxhon vetëm dy skenarë të mundshëm: të rinovojë me PSG-në ose të shkojë te Real Madrid. Nuk ka asnjë ekip tjetër në luftën për nënshkrimin e tij në muajt në vijim, pavarësisht se flitej edhe për Liverpoolin.

# NJOFTIM ZBRITJE MALLI DERI 75 %

Biznesi individual me numër Unik Identifikues 810497398 me seli në Llapna Sell dhe nr. kontakti 044777778, për arsye të likuiditetit, njofton të interesuarit qytetarë si persona fizik apo juridik mund të blejnë produkte kozmetike grimi të brendeve botërore MAX FACTOR, ARTDECO, parfuma, deodorante, qumësht trupi etj, të firmave botërore BOSS, BALDESSARINI, D&G, Lacoste, Moschino, Valentino, Versace, ngjyra flokësh, pajisje tretmani dhe mirëmbajtje floku të prodhuesit Italian DIKSON.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Bimer Group" Sh.p.k Fushë Kosovë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin për prodhimin e produkteve (kremave) kozmetikë natyrale në Llazarevë komuna e Obiliqit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 05.05.2022 në ora 09:00 në hapësirat e restorant "Massa" magjistralja Prishtinë-Mitrovicë në Mazgit, do të organizohet debat publik nga Kompania "Bimer Group" Sh.p.k Fushë Kosovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësitor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin për prodhimin e produkteve (kremave) kozmetikë natyrale në Llazarevë komuna e Obiliqit.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=NjkzeHFBUzJGZEc4dXUzeGx2NXVtZz09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Bimer Group" Sh.p.k Fushë Kosovë për impiantin për prodhimin e produkteve (kremave) kozmetikë natyrale në Llazarevë komuna e Obiliqit.

[https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet\\_dhe\\_publicimet/279/publicimet](https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

## Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek "REB BULLI", në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit:  
**044-514-373 dhe 044-199-707.**

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Almir Fetahu nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH,M, Teknike "Nexhmedin Nixha".
- ▶ Ardiana Nivokazi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi".
- ▶ Asllan Hadri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. I,II,III, IV dhe diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha".
- ▶ Shefqet Gani Sahiti nga Panorci kk Malishevë shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani" me nr. 79.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188



# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

